

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PDK-ja i kërkon Kushtetueses të vendosë masë të përkohshme për konstituimin e Kuvendit
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/pdk-ja-i-kerkon-kushtetueses-te-vendose-mase-te-perkohshm-e-per-konst-i474086
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 08:58:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:42:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	787711625e36b62508b1a28849ee77191ce5095f86cea4ede75b6ae7ca1888f4
TEKSTI	bd8e37981b757908d66e6e66d835943769991fc2776c557abe75276b96c7a59f
PAMJA	a7c766483edc498c8062eb423d4268edf9976432fe89aa043409171bb84e2dd9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	15236d6418c4a440e07cdd2b258cc1a84a6998ef3253184cd6ff23610bb34ad3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9dba7e1cf5e08da052e8f7bcad4dfd2bc0436d1ed5e23cf11abc817a3e1dcfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/15236d6418c4a440e07cdd2b258cc1a84a6998ef3253184cd6ff23610bb34ad3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

PDK-ja i kërkon Kushtetueses të vendosë masë të përkohshme për konstituimin e Kuvendit



14 Shtator 2026, 10:42, Kosova & Bota CNA



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në opozitë, i ka kërkuar të hënën Gjykatës Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme ndaj Kuvendit të ri derisa ajo të shqyrtojë nëse konstituimi i tij u bë në përputhje me Kushtetutën.

Kuvendi i Kosovës u konstituua të dielën pa zgjedhjen e nënkryetarit të dytë, i cili i takon PDK-së, pasi kjo e fundit nuk mori pjesë në seancë duke e akuzuar pushtetin për shkelje të procesit.

Dy deputetë të kësaj partie, Arian Tahiri, Përparim Gruda, së bashku me avokatin Faton Fetahu, e dërguan ankesën në emër të partisë të hënën në mëngjes.

Duke folur për media pas dorëzimit të ankesës, Tahiri tha se "është e rëndësishme që të vendoset masë e përkohshme fillimisht, në mënyrë që të mos shkaktohen dëme e situata ma të rënda në kuptim juridik dhe institucional".

"Sepse, edhe qeveria që është zgjedhur nga ky Kuvend, i cili nuk është i konstituuar dhe nuk ka ligjshmëri ta votojë qeverinë, mundet të vazhdojë të marrë vendime të jashtëligjshme", tha Tahiri.

Gruda tha se "ne deri tani kemi hezituar t'i drejtohem Kushtetueses, por meqë situata ka dalë jashtë kontrollit, pushteti është plotësisht janë Kushtetutës, neve nuk na ka mbetur rrugë tjetër përveç se t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese".

"Lëvizja Vetëvendosje nuk mund ta shkelë çdo afat dhe të përfitojë nga këto shkelje", theksoi ai.

Ata thanë se u ankan për mënyrën e zgjedhjes së kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, duke thënë se pushteti shkeli Kushtetutën duke shpërfillur afatet kushtetuese për procesin e konstituimit të organit ligjvënës.

Sipas tyre, Lëvizja Vetëvendosje në pushtet e shkeli afatin kushtetues prej 30 ditësh për konstituimin e Kuvendit dhe procedurën për thirrjen e seancës çdo 48 orë deri në konstituimin e tij.

Sipas një aktiivkimi të vitit të kaluar të Givkatës Kushtetuese. Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve. Kv afat përfundoi më 7 ausht 2026.

Pak orë pas konstituimit, Kuvendi i ri e zgjodhi edhe qeverinë e re, në një seancë të braktisur nga PDK, Aleanca dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Gruda theksoi se PDK do të ankohet në Kushtetuese të martën për mënyrën e formimit të qeverisë së re.

"Nuk mund të vazhdojmë të lejojmë që Kuvendi t'i zgjedhë organet qendrore të vendit duke pasur dilema kaq të mëdha kushtetuese", shtoi ai.

Kuvendi u shpall i konstituuar të dielën paradite, pasi u zgjodhën nënkryetarët nga radhët e LDK-së dhe komuniteteve pakicë.

Kryetarja dhe nënkryetari i parë nga LVV-ja ishin zgjedhur në një seancë të mëparshme të premtën.

PDK-ja nuk mori pjesë në seancë dhe paraprakisht e kishte tërhequr kandidaturën e Viora Çitakut për nënkryetare, kur LVV-ja nuk ia kishte votuar në seancën e të premtes.

LVV kishte thënë të shtunën vonë se do ta votonte Çitakun. Por, PDK nuk pranoi të merrte pjesë.

Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se Kuvendi "nuk mund të mbetet peng i askujt, i asnjë subjekti politik", dhe e vazhdoi procesin.

Kandidati i LDK-së për nënkryetar, Kujtim Shala, u zgjodh me 75 vota.


Pas tetë kandidaturave të dështuara nga Lista Serbe, u zgjodh edhe deputetja serbe Tanja Vujoviq. Ajo mori votat e LVV-së dhe të disa deputetëve të LDK-së.

Nga komunitetet joserbe u zgjodh deputetja boshnjake Emilija Rexhepi.

Pas votimit të nënkryetarëve, Haxhiu deklaroi se Kuvendi "konsiderohet i konstituuar".

Në një vendim të mëhershëm, Gjykata Kushtetuese kishte lënë të hapur mundësinë që Kuvendi, në rrethana të caktuara, të funksionojë edhe pa një nga anëtarët e Kryesisë, nëse zgjedhja e tij pamundësohet dhe Kryesia ka kuorum për vendimarrje.

Si një rrethanë e tillë ishte përmendur rasti kur një deputet ose grup parlamentar që ka të drejtë të propozojë anëtar të kryesisë nuk e ushtron këtë të drejtë ose e pengon procesin./REL





Të sugjeruara

Pas krizës në Ceuta/ BE, drejt ashpërsimit të politikave të emigracionit

Djegia e tragetit në Filipine/ Mund të duhen muaj për të identifikuar viktimat

Zgjedhjet në Suedi/ Blloku i krahut të majtë në avantazh

Rusia godet trenin ukrainas pak pasi Boris Johnson dhe zyrtarët e lartë evropianë largohen nga stacioni

Atmosfera politike para zgjedhjeve në dy lande gjermane

Bota shumëpolare, synimi strategjik i Kinës

Kanadaja planifikon të bëhet anëtare e asociuar e BE-së

Sulme me dronë rusë në kufi/ Evakuohet treni ku udhëtonte Boris Johnson dhe një këshilltar i Merz-it

Kurti: Asnjë gjykatë vendore e ndërkombëtare s'mund ta njollojë UÇK-në

Qeveria e re e Kosovës/ Zbardhen emrat e kabinetit të Kurtit

Votohet qeveria e re e Kosovës, Albin Kurti rizgjidhet kryeministër

Kurti shpalos programin dhe kabinetin e propozuar të qeverisë së re

Kazakistani hedh hapin e parë drejt taksive ajrore

Haxhiu mandaton Kurtin për formimin e Qeverisë/ Thirret seanca

EMRI/ Lëvizja Vetëvendosje propozon kandidatin për Kryeministër

Lufta në Ukrainë/ Rusia sulmon Kievin me mbi 450 dronë

Vijojnë përplasjet në Ngushticën e Hormuzit/ Anija goditet nga predha

Konstituohet Kuvendi i Kosovës/ Zgjidhen nënkryetarët

Sot seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës/ Çarë pritet të ndodhë


Mbahen sot zgjedhjet në Suedi/ E djathta ekstreme synon pushtetin për herë të parë

[editorial](#)

09:41 Editorial

Drejtesia shqiptare dhe katër të vërtetat që askush s'i thotë bashkë

CNA LIVESTREAM





[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.